








Universiteti Europian i Tiranës

ADRESA: BULEVARDI GJERGJ FISHTA, (ISH NPV NR.2)
WWW.UNIVERSITETIEUROPIAN.COM
MAIL:INFO@UNIVERSITETIEUROPIAN.COM

# E BËN DOT?

## guida për studentin >



MIRËSEARDHJE

Mirë se erdhët në Universitetin Europian të Tiranës (UET)! Është kënaqësi për ne që ndërmorët hapin e parë për të zbuluar se ç'ofron Universiteti Europian i Tiranës. Besojmë se, pasi të mësoni më shumë për ne, do t'i bashkëngjiteni edhe JU eksperiencës sa sfiduese aq edhe unike që ne ofrojmë, duke u bërë pjesë e një komuniteti stimulues akademik dhe intelektual. Universiteti Europian i Tiranës (UET) u themelua prej një grupi individësh që përbëhet nga akademikë, pedagogë (shqiptarë e të huaj), gazetarë dhe menaxherë me eksperiencë, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat të arsimit të lartë. Kjo nismë nuk u nxit vetëm prej kërkesës së tregut, por edhe prej dëshirës për të ndërtuar një institucion arsimor cilësor, që ofron një model edukimi alternativ e bashkëkohor, ndryshe nga modelet tradicionale ekzistuese, që nuk u përgjigjen aspak kërkesave të tregut e të kohës ku jetojmë.Kombinimi i dijeve teorike me aftësi konkrete, si dhe aftësia për të zbatur në praktikë koncepte abstrakte teorike, janë bazat e filozofisë mbi të cilën funksionon Universiteti Europian i Tiranës (UET). Ata që do të diplomohen tek ne, do të jenë të aftë të përshtaten, të orientohen dhe të kenë sukses në dinamikat komplekse të tregut të lirë. Për këtë qëllim dy dimensionet, ai teorik dhe ai praktik, do të jenë të ndërlidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Universiteti Europian i Tiranës nuk do të jetë një oaz apo kullë e fildishtë e izoluar nga përditshmëria politike, mediatike apo ligjore. Përkundrazi, ky universitet do të synojë të analizojë, të bëjë kërkime dhe t'i orientojë sa më mirë studentët e tij në këtë përditshmëri. Për këtë qëllim studentët do të pajisen me një sërë aftësish konkrete, si shkrimi dhe mendimi analitik, i shkruar e i shprehur si në shqip ashtu edhe në anglisht. Nga ana tjetër, ata do të bëhen të aftë të përdorin një sërë instrumentesh teorike për të abstraguar, analizuar dhe arsyetuar në mënyrë të pavarur mbi fenomenet komplekse që na rrethojnë.

# rreth nesh



**KËRKIMI SHKENCOR**
Kërkimi shkencor është një element mjaft i rëndësishëm i Universitetin Europian të Tiranës. Në universitetin tonë mësimëdhënia nuk konceptohet jashtë procesit kërkimor. Pedagogët tanë bëjnë kërkime dhe botojnë punime shkencore mbi fenomenet më të mprehta të shoqërisë sonë. Këto punime janë një pjesë e rëndësishme e mësimëdhënies, veçanërisht në Fakultetin e Shkencave Sociale. Për këtë qëllim Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare boton revistën shkencore Polis, e cila del në shtyp çdo tre muaj. Në këtë revistë shkencore botojnë punimet e tyre një pjesë e mirë e pedagogëve të Universitetit Europian i Tiranës si dhe intelektualë apo akademikë të njohur. Numri i parë i revistës POLIS ka dalë në Qershor 2006. Numri i dytë i revistës POLIS, i botuar në shtator 2006, titullohet "Drejt një Eurodyshimi Shqiptar" trajton integrimin në Bashkimin Europian nga një këndvështrim kritik. Numri i tretë i revistës Polis trajtoi temën Shoqëria Informale, ndërkohë që numri i ardhshëm i revistës do të fokusohet në rolin e ndërkombëtarëve në demokratizimin e Shqipërisë. Revistat e tjera shkencore janë në pregatitje. Në qershor 2007 U.E.T-i botoi librin "Lufta e fundit: Pronat e shqiptarëve në Greqi" nga Mentor Nazarko.

**KONTROLLI DHE VLERËSIMI I DIJEVE**
Në Universitetin tonë studentët i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm të dijeve të përvetësuara. Kështu nota me të cilën vlerësohen nuk është produkt i një provimi të vetëm përfundimtar, por edhe rezultat i pjesëmarrjes aktive në seminare, cilësisë së eseve që ata duhet të shkruajnë mbi çështje të lidhura me temat trajtuara gjatë leksioneve dhe vlerësimit në testet e pjesshme që zhvillohen gjatë semestrit. Në këtë mënyrë studentëve u jepet mundësia të sqarojnë paqartësitë që mund të kenë lidhur me tematikën e trajtuar, të identifikojnë dhe plotësojnë në kohë çdo boshllëk të mundshëm në njohuritë e përvetësuara. Gjatë këtij procesi pedagogët e Universitetit janë gjithmonë në dispozicion të studentëve për t'i orientuar, këshilluar dhe ndihmuar, me qëllim përmbushjen me sukses të të gjitha detyrimeve ndaj lëndëve që ata ndjekin.

**AKTIVITETET STUDENTORE, KËSHILLIM AKADEMIK**
Gjatë studimeve në U.E.T. studentëve u ofrohen mundësi të shumta për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme akademike si trainime, seminare dhe konferenca studentore brenda dhe jashtë vendit. Stafi akademik i Universitetit është gjithmonë në dispozicion të studentëve për t'u dhënë informacionin dhe këshillimin e nevojshëm gjatë fazës së aplikimit dhe më tej.

**BIBLOTEKA, SALLA E KOMPJUTERAVE, SHËRBIMET**
Universiteti Europian i Tiranës duke filluar nga viti akademik 2007-2008 do të zhvendoset në ambjentet e reja ku ofrohen kushte optimale pune dhe studimi. Studentët do të kenë mundësi të shfrytëzojnë ambjentet dhe burimet e bibliotekës, me një sipërfaqe prej rreth 300 m2, 120 vende leximi për studentët dhe kapacitet prej 20 mijë librash. Krahas burimeve hard copy, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe biblotekat online, në të cilat Universiteti Europian i Tiranës është abonuar. Ambjentet e bibliotekës janë të pajisura me izolim nga zhurmat dhe kondicionim të ngrohtë dhe të ftohtë, ashtu sikurse e gjithë godina. Gjithashtu, studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë shërbimin e internetit në një sallë kompjuterash, me një sipërfaqe prej rreth 250m2, me 80 kompjutera. Në mjediset e reja të Universitetit studentëve do t'u ofrohen shërbime fotokopjimi dhe printimi, bar, restorant, fast-food. Në ambjentin përreth godinës do të ofrohet parkim me kapacitet 140 makina, dy fusha për futboll dhe aktivitete të tjera sportive, stola dhe sipërfaqe e gjelbërt.

**KOMUNITETI SOCIAL NË U.E.T.**
Për të gjallëruar jetën studentore, në Universitetin Europian të Tiranës një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe aktiviteteve shoqërore. Që në ditët e para të jetës së tij, Universiteti organizoi party të ndryshme për të nxitur ndjenjën e grupit mes studentëve, praktikë kjo që rezultoi e suksesshme në thellimin e njohjeve dhe ndërveprimit mes tyre. Tashmë janë krijuar disa skuadra minifutbolli, në bazë të degëve përkatëse. Universiteti ka marrë inisiativa për të organizuar udhëtime turistike brenda dhe jashtë vendit, si në Mal të Zi dhe Kroaci. Mund të thuhet se gjallëria e jetës studentore ka ardhur në rritje dhe e ka bërë universitetin një mjedis edhe më interaktiv dhe tërheqës për studentët.



# mirëseardhja





**Prof. Asoc. Dr. Adrian CIVICI**
Rektor

**Të mësohemi të STUDIOJMË në një botë në ndryshim**

Suksesi profesional fillon nga një zgjedhje e mirë e formimit dhe studimeve universitare. Ne, në këtë guidë për studentin, ju paraqesim mundësitë, potencialet dhe hapësirat që ju ofron Universiteti Europian i Tiranës (U.E.T) në rrugën tuaj drejt suksesit. Deviza jonë është ajo e universiteteve më prestigjoze ndërkombëtare në këtë mijëvjeçar të ri "Të mësohemi të STUDIOJMË në një botë në ndryshim" .

Duke zgjedhur dhe ndjekur studimet në U.E.T. ju do të bashkëpunoni me një staf akademik të përzgjedhur, të përbërë nga ekspertë të shquar e mjaft kompetentë, të cilët kanë kryer studime e kërkime në universitete prestigjoze perëndimore. Kurikulumet dhe programet tona mësimore janë të bazuara në eksperiencën dhe përvojën më të mirë shqiptare dhe ndërkombëtare. U.E.T-i ofron laboratore dhe metoda mësimdhënieje bashkëkohore, të cilat ju zhvillojnë aftësitë analitike, mendimin kritik, krijimtarinë dhe inteligjencën. Me ne do të keni mundësi të bëheni pjesë e shoqërive të informacionit dhe ekonomisë së dijes, të përdorni gjerësisht teknologjitë e reja të informacionit, si dhe të kombinoni në mënyrë cilësore njohuritë teorike dhe aftësitë praktike për t'u përshtatur me tregun e punës dhe dinamikat e zhvillimit politik, ekonomik e social në Shqipëri e më gjerë. Ne ju ftojmë të bëheni pjesë e një mjedisi intelektual, sfidues, stimulues, shumë komunitar e argëtues. Për studentët më të mirë është vënë në dispozicion një sistem i gjerë bursash motivuese e nxitëse për rezultate sa më të larta.

U.E.T.-i është ndërtuar e funksionon në përputhje të plotë me kriteret dhe kërkesat e "Kartës së Bolonjës" dhe eksperiencën e universiteteve nga më të shquarat në Europë dhe Amerikë, duke mundësuar transferimin e krediteve dhe ndjekjen e mëtejshme të studimeve jashtë vendit. Bashkëpunimi me universitete të shquara perëndimore, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me këto institucione, si dhe aplikimi i programeve të shkëmbimit akademik mes studentëve dhe stafeve akademike reciproke është pjesë integrale e filozofisë të universitetit tonë.

Materiali bazë mësimor e pedagogjik mbështetet në libra dhe tekste të autorëve më të shquar botërorë të fushave të ndryshme të dijes, duke garantuar një akses të gjerë e të lehtë të studentëve në burimet më cilësore të informacionit dhe materialeve didaktike të domosdoshme për një formim profesional cilësor, të kërkuar e të vlerësuar në tregun e punës. Prezenca e lektorëve dhe ekspertëve të shquar ndërkombëtarë, si dhe figurave të spikatura shqiptare, është bërë pjesë e pandarë e auditorëve të universitetit tonë, në funksion të zgjerimit të horizontit të studentëve, nxitjes së debatit, zgjerimit të problematikës dhe eksperiencave profesionale e drejtuese në kuadër të thellimit të komunikimit e dialogut profesional e institucional.

Ju ftojmë të ndërtojmë sëbashku të ardhmen tuaj në U.E.T., një mjedis që do t'ju pajisë me dije e njohuri moderne e bashkëkohore, një qendër e përpunimit të ideve e vizioneve për të ardhmen. Tek ne do të gjeni një mundësi oportune për t'u formuar në një mjedis akademik, dinamik e bashkëkohor, për t'u bërë një ekspert i përgatitur e kompetent në jetën profesionale, një qytetar i kulturuar dhe aktiv në një shoqëri të lirë dhe demokratike.

www.universitetieuropian.com
info@universitetieuropian.com

Ky fakultet synon të përgatitë studentët në fushën e shkencave politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, në gazetari dhe në marrëdhëniet me publikun. Në harmoni me filozofinë e Universitetit Europian i Tiranës, programi i këtij fakulteti është ndërtuar duke kombinuar konceptet bazë teorike me ato praktike, në mënyrë që studentët të orientohen lehtë në tregun e punës. Në këtë fakultet i është dhënë një rëndësi e veçantë dimensionit të shkrimit akademik dhe mendimit kritik. Lëndët do të zhvillohen në klasa të vogla dhe ndërvepruese. Vlerësimi studentëve s'do të bëhet vetëm në fund, por gjatë gjithë semestrit. Mësimdhënia nuk do të përqendrohet vetëm tek tekstet klasike, por edhe tek kërkimet e bëra nga vetë pedagogët. Për këtë qëllim, në këtë fakultet janë përzgjedhur pedagogë shqiptarë e të huaj, të cilët jo vetëm që e zotërojnë fushën e mësimdhënies, por kanë bërë edhe kërkime e një sërë punimesh shkencore. Pjesa më e madhe e pedagogëve tanë janë të shkolluar në universitetet më në zë të Perëndimit.Programi i Fakultetit të Shkencave Sociale është ndërtuar sipas sistemit të Bolonjës. Një student duhet të përmbushë 180 kredite mësimore që të diplomohet në njërën prej katër degëve që ofron ky fakultet.Ky fakultet është i organizuar sipas sistemit të studimeve të Bolonjës me sistemin (3+2): 3 vite diplomë universitare plus 2 vite master.

## DIPLOMAT DHE PROFESIONET

**Marrëdhënie publike/Komunikim**

**a.** Drejtues i marrëdhënieve publike në administratën shtetërore (në çdo zyrë të marrëdhënieve publike në ministri dhe në institucionet kryesore); **b.** Drejtues i marrëdhënieve publike në ndërmarrjet publike (Telekom, KESH, etj); **c.** Zëdhënës në të gjithë kategoritë e mësipërme; **d.** Drejtues i marrëdhënieve publike në partitë politike; **e.** Drejtues i marrëdhënieve publike në organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri; **f.** Këshilltar për marrëdhëniet publike, këshilltar për media, ose këshilltar për komunikimin për institucionet kryesore të vendit (kryeministri, presidenti, kryetari i kuvendit, etj).;
**g.** Drejtues i marrëdhënieve publike në ndërmarrjet e mëdha private; **h.** Eksperti i komunikimit dhe marrëdhënieve publike në agjensitë private që ofrojnë shërbime marketingu (agjensi reklamash, agjensi marketingu, etj); **i.** Gazetar/redaktor/analist në media; **j.** Pedagog; **k.** Angazhim publik dhe politik

**Shkenca politike**

**a.** Administrata shtetërore në sektorët e përgatitjes së politikave; **b.** Administrata shtetërore në sektorët e politikave publike; **c.** Këshilltar politik pranë pozicioneve të larta shtetërore ose partive politike;
**d.** Ekspert/politolog; **e.** Ekspert pranë organizatave ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri;
**f.** Gazetar/redaktor/analist në media; **g.** Pedagog; **h.** Angazhim publik dhe politik

**Marrëdhënie ndërkombëtare**

**a.** Administrata shtetërore që menaxhon marrëdhëniet e Shqipërisë me jashtë (Ministria e Jashtme, Ministria e Integrimit dhe shumë drejtori të ministrive të tjera të angazhuara në proceset e integrimit apo bashkëpunimit me jashtë); **b.** Trupi diplomatik shqiptar jashtë vendit (ambasada, përfaqësi diplomatike, etj);
**c.** Ekspert pranë organizatave ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri; **d.** Gazetar/redaktor/analist në media; **e.** Pedagog; **f.** Angazhim publik dhe politik

# fakulteti i shkencave sociale



**TE DHENAT PER KURSET E STUDIMIT**

1 – DIPLOMAT : a- Gazetari, b- Komunikim – Marrëdhënie publike, c- Shkenca politike, d – Marrëdhënie ndërkombëtare
2- Formimi që do të arrihet përmes diplomave.

**A- DIPLOMA GAZETARI**

Përmes këtij kursi studimesh synohet përgatitja e gazetarëve dhe reporterëve të përgjithshëm për median shqiptare, të cilët do të jenë të aftë të përmbushin detyrat në pozicionin e reporterit, gazetarit, korrespondentit, të dërguarit të posaçëm dhe redaktorit në median shqiptare. Po ashtu ato do të jenë të përgatitur edhe me aftësi alternative për të punuar dhe në sektorin e komunikimit dhe marrëdhënieve publike.

**B- DIPLOMA: KOMUNIKIM - MARRDHENIE PUBLIKE**

Përmes këtij kursi studimeve synohet përgatitja e specialistëve të nivelit universitar ne shkencat e komunikimit dhe marrëdhëniet publike, që të jenë të aftë të kryejnë funksione të ndryshme në tregun e punës si specialistë të medias, të komunikimit, të marrëdhënieve publike, hartues dhe ekzekutues të fushatave publicitare, drejtues dhe punonjës të zyrave të shtypit dhe marrëdhënieve me publikut në sektorin publik dhe privat.

**C- DIPLOMA: SHKENCA POLITIKE**

Përmes këtij kursi studimesh synohet përgatitja e specialistëve të nivelit universitar në shkencat politike, që të jenë të aftë të njohin shkencat politike në tërësi, për të punuar në sektorin e shoqërisë civile, në media, në organizmat politike, specialistë në administratës publike në të gjithë sektorët e saj lidhur me çështjet politike. Gjithashtu të diplomuarit në këtë fushë janë të aftë për studimeve dhe kërkime fillestare në fushën e shkencave politike.

**D- DIPLOMA: MARREDHENIE NDERKOMBETARE**

Përmes këtij kursi studimesh synohet përgatitja e specialistëve të nivelit universitar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, që të jenë të aftë të punojnë në sektorin e diplomacisë, të organizatave ndërkombëtare, në administratën publike në sektorët e marrëdhënieve me jashtë, në shoqërinë civile dhe media për çështjet që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacinë. Po ashtu ato janë të pajisur më aftësi teorik për të kryer studimeve dhe kërkime fillestare për çështje që kanë të bëjnë me diplomacinë.

**3-** Sistemi i studimeve është me kohë të plotë.
**4-** Kohëzgjatja e kursit të studimeve është 3 vjet.
**a-** numri total i orëve mësimore në klasë është në përputhje me shpërndarjen e orë lëndëve të detyrueshme dhe opsionale, të cilat bëjnë 60 kredite në një vit, ose 180 kredite në total për të tre vjetët, sipas këtij parimi: *6 kredite = 3 orë leksione + 1 orë seminar, 5 kredite = 2 ore leksione+ 1 orë seminar, 4 kredite = 1 orë leksion = 2 orë seminare, 3 kredite = 1 orë leksion + 1 orë seminar.*
**b-** lëndët e teorisë i përgjigjen në tabelën bashkangjitur lëndëve me 6 kredite, 5 kredite, 3 kredite.
**c-** lëndët e praktike i përgjigjen në tabelën bashkangjitur lëndëve me 4 kreditë.
**5-** Kohëzgjatja e studimeve është 3 vjet.
Shpërndarja e lëndëve sipas viteve, kreditet e akorduara për secilën lëndë dhe parimi i përkthimit në orë mësimore në klasë të secilës lëndë në tabelën bashkangjitur. ( në faqen 5)
**6-** Në përputhje me sistemin e Bolonjës lëndët janë katër grupe:

**I- LENDET E DETYRUESHME:** *70 % e krediteve; 42 kredite / vit; 126 kredite / 3 vjet*

**a-Lëndët e detyrueshme për të gjitha degët**

Këtu bëjnë pjesë lëndët e formimit të përgjithshëm, hyrjet në shkencat përkatëse, si dhe lëndët të cilat janë ndihmëse për çdo student lidhur në kërkimin shkencor dhe metodat e kërkimit.

**a-** Lëndët e detyrueshme specifike për secilën degë

Këtu bëjnë pjesë ato lëndë, të cilat nuk mund të ndiqet nga kurset e tjera, pasi përbëjnë shtyllën kryesore të dijeve dhe aftësive për degën përkatëse

**II- LENDET OPSIONALE:** *30 % e krediteve; 18 kredite / vit; 54 kreditë /3 vjet*

**a-** Lëndë opsionale për të gjitha degët

Këto lëndë janë të formimit të përgjithshëm, por më pak të rëndësishme se lëndët e klasifikuara të detyrueshme, të cilat i japin mundësi studentit të secilës degë të zgjedhë në raport me interesat e tij në këtë bashkësi lëndësh, duke ndërtuar vetë këtë pjesë të planit mësimor.

**b-** Lëndët opsionale specifike

Këto lëndë janë vazhdim, specifikim apo thellim i lëndëve të detyrueshme speciale, të cilat japin mundësin studentëve të secilës degë të marrin njohuri të thelluara në lëndët që përbëjnë identitetin e kursit të tyre të studimit.

**7** – Punimi i diplomës do jetë i detyrueshëm për marrjen e diplomës. Ai do të kryhet në fund të vitit të tretë, në semestrin e dytë nën udhëheqjen e një pedagogu dhe do të ketë numrin përkatës të krediteve
**8-** Informacion për stafin akademik për secilin departament
**9** – Baza didaktike për realizimin e kurseve do të mbështetet:
**a-** Burimet e universitetit: Laboratori i informatikës, biblioteka
**b-** Burime të jashtme: Kontraktim i burimeve të jashtme për disa lëndë specifike të mjeshtërisë profesionale, si redaksi mediash
**10-** Për secilën degë është parashikuar një praktikë mësimore/internship, që do të kryhet në fund të vitit të tretë në institucione të ndryshme të medias, shoqërisë civile, administratës publike, organizata ndërkombëtare, sektor privat sipas preferencave të studentëve dhe interesave të tyre akademike dhe profesionale.

**I - LËNDË TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË UNIVERSITETIN**

**VITI I PARË**

| | GAZETARI | C | MP - KOMUNIKIMI | C | SHKENCA POLITIKE | C | MARREDHENIE NDERKOMBETARE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkrim akademik I | 3 | Shkrim akademik I | 3 | Shkrim akademik I | 3 | Shkrim akademik I | 3 |
| 2 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Makro ekonomi | 5 | Makro ekonomi | 5 | Makro ekonomi | 5 | Makro ekonomi | 5 |
| 2 | Mikro ekonomi | 5 | Mikro ekonomi | 5 | Mikro ekonomi | 5 | Mikro ekonomi | 5 |

**VITI I TRETË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Punimi i diplomës | 10 | Punimi i diplomës | 10 | Punimi i diplomës | 10 | Punimi i diplomës | 10 |
| 2 | Praktikë / internship | 5 | Praktikë / internship | 5 | Praktikë / internship | 5 | Praktikë / internship | 5 |

**II - LËNDË TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË FAKULTETIN E SHKENCAVE SOCIALE**

**VITI I PARË**

| | GAZETARI | C | MP - KOMUNIKIMI | C | SHKENCA POLITIKE | C | MARREDHENIE NDERKOMBETARE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkrim akademik II | 3 | Shkrim akademik II | 3 | Shkrim akademik II | 3 | Shkrim akademik II | 3 |
| 2 | Nocione në filozofi | 5 | Nocione në filozofi | 5 | Nocione në filozofi | 5 | Nocione në filozofi | 5 |
| 3 | Nocione të shkencave politike | 5 | Nocione të shkencave politike | 5 | Nocione të shkencave politike | 5 | Nocione të shkencave politike | 5 |
| 4 | Elementë të komunikimit | 5 | Elementë të komunikimit | 5 | Elementë të komunikimit | 5 | Elementë të komunikimit | 5 |
| 5 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 |
| 6 | Histori e mendimit politik | 5 | Histori e mendimit politik | 5 | Histori e mendimit politik | 5 | Histori e mendimit politik | 5 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Metoda kërkimi | 4 | Metoda kërkimi | 4 | Metoda kërkimi | 4 | Metoda kërkimi | 4 |
| 2 | Anglisht akademik | 3 | Anglisht akademik | 3 | Anglisht akademik | 3 | Anglisht akademik | 3 |
| 3 | E drejtë publike | 5 | E drejtë publike | 5 | E drejtë publike | 5 | E drejtë publike | 5 |

**VITI I TRETË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Filozofia e së drejtës | 5 | Filozofia e së drejtës | 5 | Filozofia e së drejtës | 5 | Filozofia e së drejtës | 5 |
| 2 | Histori bashkëkohore | 5 | Histori bashkëkohore | 5 | Histori bashkëkohore | 5 | Histori bashkëkohore | 5 |
| 3 | Matje/ interpretim i opinionit publik | 4 | Matje/ interpretim i opinionit publik | 4 | Matje/ interpretim i opinionit publik | 4 | Matje/ interpretim i opinionit publik | 4 |

**III- LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE**

**VITI I PARË**

| | GAZETARI | C | MP - KOMUNIKIMI | C | SHKENCA POLITIKE | C | MARREDHENIE NDERKOMBETARE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkrim/ raportim I lajmit I | 4 | Teoritë e komunikimit | 5 | Politika krahasuese | 3 | Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare | 5 |
| 2 | Shkrim/ raportim I lajmit II | 4 | Reklama & promocioni | 3 | Partitë politike | 5 | Organizatat ndërkombëtare | 3 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjinitë gazetareske | 4 | Media-marketingu | 5 | Shteti në prespektivë | 3 | Gjeopolitika | 5 |
| 2 | Audio – media | 4 | Sociologji e komunikimit | 5 | Ekonomia & politikat publike | 6 | Siguria e strategjitë e mbrotjes | 3 |
| 3 | Etika për median | 3 | Komunikimi ndërpersonal | 3 | Mendimi politik bashkëkohor | 5 | Diplomacia dhe protokolli | 4 |
| 4 | Print – media | 4 | Burimet njerëzore | 3 | Teoritë feministe | 3 | Negocimi i konflikteve & Arbitrazhi | 5 |
| 5 | Historia e medias ndërkomb/shqiptare | 5 | Shkrim/ raportim I lajmit I | 4 | Utilitarizmi dhe shteti social | 3 | E drejte ndërkombetare publike | 3 |

**VITI I TRETË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Video – media | 4 | Konceptim/ aplikim i reklamave | 4 | Histori e mendimit ekonomik | 5 | Kolonializmi/ post kolonializmi | 3 |
| 2 | Redaktim / Editim | 4 | Strategji/ teknika të fushatimit | 4 | E drejtë civile 1 | 5 | Islami në rendin botëror | 4 |
| 3 | Multimedia / Media on line | 5 | E drejtë civile 1 | 5 | Liberalizmi klasik / neoliberalizmi | 3 | Ekonomi ndërkombëtare | 6 |

**IV- LËNDË OPSIONALE PËR TË GJITHË FAKULTETIN**

**VITI I PARË**

| | GAZETARI | C | MP - KOMUNIKIMI | C | SHKENCA POLITIKE | C | MARREDHENIE NDERKOMBETARE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjuhë shqipe e aplikuar | 4 | Gjuhë shqipe e aplikuar | 4 | Gjuhë shqipe e aplikuar | 4 | Gjuhë shqipe e aplikuar | 4 |
| 2 | Qytetërimi europian | 5 | Qytetërimi europian | 5 | Qytetërimi europian | 5 | Qytetërimi europian | 5 |
| 3 | Qeverisja e politika në Shqipëri | 3 | Qeverisja e politika në Shqipëri | 3 | Qeverisja e politika në Shqipëri | 3 | Qeverisja e politika në Shqipëri | 3 |
| 4 | Historia e Europës & integrimit europian | 5 | Historia e Europës & integrimit europian | 5 | Historia e Europës & integrimit europian | 5 | Historia e Europës & integrimit europian | 5 |
| 5 | Nocione të sociologjisë | 5 | Nocione të sociologjisë | 5 | Nocione të sociologjisë | 5 | Nocione të sociologjisë | 5 |
| 6 | Historia e shtetit shqiptar | 5 | Historia e shtetit shqiptar | 5 | Historia e shtetit shqiptar | 5 | Historia e shtetit shqiptar | 5 |
| 7 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Komunikimi politik | 5 | Komunikimi politik | 5 | Komunikimi politik | 5 | Komunikimi politik | 5 |
| 2 | Nocione të psikologjisë | 5 | Nocione të psikologjisë | 5 | Nocione të psikologjisë | 5 | Nocione të psikologjisë | 5 |
| 3 | Histori arti dhe estetike | 5 | Histori arti dhe estetike | 5 | Histori arti dhe estetike | 5 | Histori arti dhe estetike | 5 |
| 4 | Statistikë | 4 | Statistikë | 4 | Statistikë | 4 | Statistikë | 4 |
| 5 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 |
| 6 | Frengjisht I/ II/ III | 5 | Frengjisht I/ II/ III | 5 | Frengjisht I/ II/ III | 5 | Frengjisht I/ II/ III | 5 |

**VITI I TRETË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tradita / morali/ seksualiteti | 3 | Tradita / morali/ seksualiteti | 3 | Tradita / morali/ seksualiteti | 3 | Tradita / morali/ seksualiteti | 3 |
| 2 | Analizë e ligjërimit | 3 | Analizë e ligjërimit | 3 | Analizë e ligjërimit | 3 | Analizë e ligjërimit | 3 |

**V-LËNDË OPSIONALE SPECIFIKE**

**VITI I PARË**

| | GAZETARI | C | MP - KOMUNIKIMI | C | SHKENCA POLITIKE | C | MARREDHENIE NDERKOMBETARE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Legjislacioni për median | 3 | Zyra e shtypit / Zëdhënësi | 4 | Sistemet elektorale | 3 | Politika e jashtme e Shqiperisë | 3 |
| 2 | Agjensia | 4 | Foto / Imazhi | 4 | Qeverisja, institucionet & politika ne BE | 5 | Politika e jashtme e SHBA-së | 5 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gazetari ekonomike | 3 | E folura në publik | 4 | Teori e vendimarrjes racionale | 5 | Nacionalizmi | 5 |
| 2 | Revista /zhvillimi/ sporti | 4 | Komunikimi kulturor | 3 | Qeverisja dhe politika në SHBA | 5 | Politika e jashtme e BE-së | 5 |

**VITI I TRETË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Intevista & Talk Show | 4 | Lobimi/ negocimi | 3 | Post – modernizmi | 3 | Shoqëria e politika në Ballkan | 3 |
| 2 | Editoriali/ komenti/ analiza | 4 | Lidershipi dhe komunikimi | 3 | Fushata elektorale | 3 | Shoqëria e politika në Lindjen e Mesme | 3 |
| 3 | Gazetaria investigative | 4 | Kërkimet e tregut | 4 | Shoqëria civile / grupet e interesit | 3 | Globalizmi | 3 |

www.universitetieuropian.com
info@universitetieuropian.com

Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga dy departamente: Departamenti i së Drejtës Publike e Civile dhe nga Departamenti i së Drejtës Penale. Ndryshe nga koncepti tradicional shqiptar, që e shikon edukimin në sferën e drejtësisë si edukim ekskluzivisht juridik, filozofia e Universitetit Europian i Tiranës është ndërthurja e programit të Fakultetit të Drejtësisë me programin mësimor të Fakultetit të Shkencave Sociale. Në këtë mënyrë do të shmanget ngushtimi i horizontit arsimor të studentit vetëm në lëndë juridike, të cilit do t'i bashkëngjiten lëndë apo koncepte ndihmëse të shkencave sociale, që e aftësojnë një jurist të gjykojë më mirë, të mendojë në mënyrë analitike apo të të abstragojë në nivelin konceptual dhe teorik.
Në të njëjtën kohë, një rëndësi e veçantë në këtë fakultet u është dhënë lëndëve themelore për përgatitjen e juristëve të aftë. Për këtë qëllim, janë zgjedhur disa nga juristët, konstitucionalistët, penalistët apo gjyqtarët më me përvojë. Stafi pedagogjik kombinon në mënyrë të harmonizuar brezin e ri të juristëve të shkolluar në Perëndim, me brezin e juristëve me përvojë konkrete në legjislacionin shqiptar. Kështu është siguruar vazhdimësia midis risisë perëndimore dhe traditës lokale. Në këtë mënyrë, studentët do të njihen me konceptet më bashkëkohore juridike në botë, si dhe me traditën e gjatë juridike, si jashtë edhe brenda vendit.
Programi i Fakultetit të Drejtësisë u lejon studentëve që brenda formimit të përgjithshëm juridik të kenë mundësi të përqendrohen edhe në profile të caktuara, çka i paraprin një specializimi që ata mund të marrin në të ardhmen. Për këtë qëllim, brenda programit të përgjithshëm ekzistojnë profilet e biznesit, ai i së drejtës publike dhe kushtetuese, dhe ai i së drejtës evropiane ndërkombëtare.
Ky fakultet është i organizuar sipas sistemit të studimeve të Bolonjës me sistemin 3+ 2, ku në fillim është përgatitur organizimi i kurseve të ciklit të parë 3- vjeçar. I gjithë sistemi i ngarkesës, i ndarjes së grupeve të lëndëve, i mënyrës së mësimdhënies, i formave të kontrollit do të mbështetet në kriteret që parasheh Karta e Bolonjës.

## DIPLOMAT DHE PROFESIONET

**Profili "E drejta e biznesit**
**a.** Jurist në studiot private që merren me çështjet e biznesit;**b.** Jurist në institucionet bankare; **c.** Jurist në administratën shtetërore që merret me financat; **d.** Jurist në ndërmarrjet private; **e.** Jurist në ndërmarrjet publike; **f.** Pedagog;

**Profili "E drejta publike dhe kushtetuese"**
**a.** Jurist në administratën shtetërore; **b.** Jurist në institucionet kushtetuese; **c.** Këshilltar politik; **d.** Jurist në organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri; **e.** Gazetar/redaktor/analist në media; **f.** Pedagog; **g.** Angazhim publik dhe politik

**Profili "E drejta evropiane dhe ndërkombëtare"**
**a.** Jurist në administratën shtetërore (kryesisht në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Integrimit dhe në drejtori të ministrive të tjera të angazhuara në proceset e integrimit apo bashkëpunimit me jashtë); **b.** Jurist në organizatat ndërkombëtare që punojnë në Shqipëri; **c.** Këshilltar politik; **d.** Pedagog; **e.** Angazhim publik dhe politik

# fakulteti i drejtësisë





**TE DHENAT PER KURSET E STUDIMIT**

**1 – DIPLOMA: JURIST I PERGJITSHEM**

Profilet e mundshme: a- jurist, specialiteti: biznes, b-jurist, specialiteti: e drejta publike e kushtetuese; c- jurist, specialist për të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare.

**2-** Formimi që do të arrihet përmes diplomave.

**A- JURIST I PERGJITSHEM**

Përmes këtij kursi studimesh synohet përgatitja juristëve në nivelin universitar të karaktërit të përgjithshëm, të cilat do të kenë bazat për profesionin e juristit, pjesëtarit të zyrave juriridike, konsulent juridik. Po ashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi, ata janë kandidatë për të marrë pjesë në konkursin për licencën e avokatit, noterit. Si dhe janë të aftë për avancuar në ciklin e dytë të studimeve "master".

**II- Profilet:** Të gjithë studentët kanë gjithashtu të drejtë që, duke zgjedhur një numër të të caktuar kursesh të lëndëve opsionale specifike të grupara sipas tre drejtimeve parkatëse (shih shtojcën 1 / juridik), ata mund të përfitojnë sipas dëshirës në diplomën e tyre edhe specialitetet përkatëse të poshtëshënuara. Ata duhet të ndjekin nga grupi i lëndëve opsionale specifike jo më pak se 8 kurse nga 13 të ofruara gjithsej.

**a- jurist: e drejta e biznesit**

Synohet t'u japë studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën për biznesin, sistemin ekomonik, të drejtat e pronësive, format e reja ekonomike dhe kontraktuale etj.

**b- Jurist: e drejta publike**

Synohet t'u jepet studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën publike, të drejtën kushtetuese, evoluimet e këtyre të drejtave në shoqëritë bashkëkohore dhe marrëdhëniet e tyre me sistemin politik.

**c-jurist: e drejta evropiane dhe ndërkombëtare**

Synohet t'u jepet studentëve përmes grupit të lëndëve opsionale njohuri shtesë lidhur me të drejtën e Bashkimit Evropian, traktatatet e BE-së, si dhe të drejtën ndërkombëtare, institucionet ndërkombëtare etj.

**3-** Sistemi i studimeve është me kohë të plotë.

**4-** Kohëzgjatja e kursit të studimeve është 3 vjet.

**a-** numri total i orëve mësimore në klasë është në përputhje me shpërndarjen e orë lëndëve të detyrueshme dhe opsionale, të cilat bëjnë 60 kredite në një vit, ose 180 kredite në total për të tre vjetët sipas këtij parimi:
*6 kredite = 3 orë leksione + 1 orë seminar, 5 kredite = 2 ore leksione+ 1 orë seminar, 4 kredite = 1 orë leksion = 2 orë seminare, 3 kredite = 1 ore leksion + 1 orë seminar.*

**b-** lëndët e teorisë u përgjigjen në tabelen bashkangjitur lëndëve me 6 kredite, 5 kredite, 3 kredite.

**c-** lëndët praktike u përgjigjen në tabelen bashkangjitur lëndëve me 4 kredite.

**5-** Kohëzgjatja e studimeve është 3 vjet.

Shpërndarja e lëndëve sipas viteve, kreditet e akorduara për secilën lëndë dhe parimi i përkthimit në orë mësimore në klasë të secilës lëndë në tabelën bashkangjitur (në faqen 7)

**6-** Në përputhje me sistemin e Bolonjës, lëndët janë grupur në këto katër grupe:

**I- LENDET E DETYRUESHME**: *70 % e krediteve; 42 kredite / vit; 126 kredite / 3 vjet*

**a-**Lëndët e detyrueshme për të gjitha degët
Këtu bëjnë pjesë lëndët e fomimit të pëgjithshëm, hyrjet në shkencat përkatëse, si dhe lëndër të cilat janë ndihmëse për çdo student lidhur në kërkimin shkencor dhe metodat e kërkimit.

**b -**Lëndët e detyrueshme specifike për secilën degë
Këtu bëjnë pjesë ato lëndë, të cilat nuk mund të ndiqet nga kurset e tjera, pasi përbëjnë shtyllën kryesore të dijeve dhe aftësive për degën përkatëse

**II- LENDET OPSIONALE:** *30 % e krediteve; 18 kredite / vit; 54 kreditë /3 vjet*

**a-** Lëndë opsionale për të gjitha degët
Këto lëndë janë të formimit të përgjitshëm, por më pak të rëndësishme se lëndët e klasifikuara të detyrueshme, të cilat i japin mundësi studentit të secilës degë të zgjedhë në raport me interesat e tij në këtë bashkësi lëndësh, duke ndërtuar vetë këtë pjesë të planit mësimor.

**b-** Lëndët opsionale specifike
Këto lëndë janë vazhdim, specifikim apo thellim i lëndëve të detyrueshme speciake, të cilat u japin mundësin studentëve të secilës degë të marrin njohuri të thellura në lendët që përbëjnë identitetin e kursit të tyre të studimit.

**7 –** Punimi i diplomës do të jetë i detyrueshëm për marrjen e diplomës. Ai do të kryhet në fund të vitit të tretë, në semestrin e dytë, nën udhëheqjen e një pedagogu dhe do të ketë numrin përkatës të krediteve

**8-** Informacion për stafin akademik për secilin department

**9 –** Baza didaktike për realizimin e kurseve do të mbështetet:

**a-** Burimet e universitetit: Laboratori i informatikës, biblikoteka.

**b-** Burime të jashtme: Kontraktim i burimeve të jashtme për disa lëndë specifike si kabinete avokatësh dhe noterësh, gjykatat e të gjitha shkallëve, intitucionet e tjera të drejtësisë dhe aktorë të tjerë publikë apo privatë

**10-** Për secilën degë është parashikuar një praktikë mesimore/ internship, që do të kryhet në fund të vitit të tretë në institucione të ndryshme të medias, shoqërisë civile, administratës publike, organizata ndërkombëtare, sektor privat sipas preferencave të studentëve dhe interesave të tyre akademike dhe profesionale.

**I - LËNDË TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË UNIVERSITETIN**

**VITI I PARË**

| | JURIDIK I PËRGJITHSHËM | C | E DREJTË BIZNESI | C | E DREJTA PUBLIKE & KUSHTETUESE | C | E DREJTA NDËRKOMBËTARE & EUROPIANE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shkrim akademik I | 3 | Shkrim akademik I | 3 | Shkrim akademik I | 3 | Shkrim akademik I | 3 |
| 2 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Makro ekonomi | 5 | Makro ekonomi | 5 | Makro ekonomi | 5 | Makro - ekonomi | 5 |
| 2 | Mikro ekonomi | 5 | Mikro ekonomi | 5 | Mikro ekonomi | 5 | Mikro ekonomi | 5 |

**VITI I TRETË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Praktikë / Internship | 5 | Praktikë / Internship | 5 | Praktikë / Internship | 5 | Praktikë / Internship | 5 |
| 2 | Punimi i diplomës | 6 | Punimi i diplomës | 6 | Punimi i diplomës | 6 | Punimi i diplomës | 6 |

**II - LËNDË TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË FAKULTETIN E DREJTËSISË**

**VITI I PARË**

| | JURIDIK I PËRGJITHSHËM | C | E DREJTË BIZNESI | C | E DREJTA PUBLIKE & KUSHTETUESE | C | E DREJTA NDËRKOMBËTARE & EUROPIANE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Historia e shtetit/ institucioneve | 5 | Historia e shtetit/ institucioneve | 5 | Historia e shtetit/ institucioneve | 5 | Historia e shtetit/ institucioneve | 5 |
| 2 | Historia e shtetit shqiptar | 5 | Historia e shtetit shqiptar | 5 | Historia e shtetit shqiptar | 5 | Historia e shtetit shqiptar | 5 |
| 3 | E drejta publike | 5 | E drejta publike | 5 | E drejta publike | 5 | E drejta publike | 5 |
| 4 | Shkrim / arsyetim ligjor | 4 | Shkrim / arsyetim ligjor | 4 | Shkrim / arsyetim ligjor | 4 | Shkrim / arsyetim ligjor | 4 |
| 5 | E drejta civile I | 5 | E drejta civile I | 5 | E drejta civile I | 5 | E drejta civile I | 5 |
| 6 | E drejta romake | 6 | E drejta romake | 6 | E drejta romake | 6 | E drejta romake | 6 |
| 7 | E drejta kushtetuese | 6 | E drejta kushtetuese | 6 | E drejta kushtetuese | 6 | E drejta kushtetuese | 6 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | E drejta penale 1 | 5 | E drejta penale 1 | 5 | E drejta penale 1 | 5 | E drejta penale 1 | 5 |
| 2 | E drejta penale 2 | 5 | E drejta penale 2 | 5 | E drejta penale 2 | 5 | E drejta penale 2 | 5 |
| 3 | E drejta civile 2 | 3 | E drejta civile 2 | 3 | E drejta civile 2 | 3 | E drejta civile 2 | 3 |
| 4 | E drejta e detyrimeve | 5 | E drejta e detyrimeve | 5 | E drejta e detyrimeve | 5 | E drejta e detyrimeve | 5 |
| 5 | E drejta tregtare | 3 | E drejta tregtare | 3 | E drejta tregtare | 3 | E drejta tregtare | 3 |
| 6 | Procedura civile | 4 | Procedura civile | 4 | Procedura civile | 4 | Procedura civile | 4 |
| 7 | Procedura penale | 4 | Procedura penale | 4 | Procedura penale | 4 | Procedura penale | 4 |
| 8 | E drejta ndërkombëtare publike | 3 | E drejta ndërkombëtare publike | 3 | E drejta ndërkombëtare publike | 3 | E drejta ndërkombëtare publike | 3 |

**VITI I TRETE**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | E drejta administrative | 5 | E drejta administrative | 5 | E drejta administrative | 5 | E drejta administrative | 5 |
| 2 | E drejta e punës | 3 | E drejta e punës | 3 | E drejta e punës | 3 | E drejta e punës | 3 |
| 3 | E drejta familjare | 3 | E drejta familjare | 3 | E drejta familjare | 3 | E drejta familjare | 3 |
| 4 | E drejta europiane | 5 | E drejta europiane | 5 | E drejta europiane | 5 | E drejta europiane | 5 |
| 5 | E drejta ndërkombëtare private | 3 | E drejta ndërkombëtare private | 3 | E drejta ndërkombëtare private | 3 | E drejta ndërkombëtare private | 3 |
| 6 | Kriminalistikë | 4 | Kriminalistikë | 4 | Kriminalistikë | 4 | Kriminalistikë | 4 |
| 7 | Filozofia e së drejtës | 5 | Filozofia e së drejtës | 5 | Filozofia e së drejtës | 5 | Filozofia e së drejtës | 5 |
| 8 | E drejtë financiare | 3 | E drejtë financiare | 3 | E drejtë financiare | 3 | E drejtë financiare | 3 |

**III- LËNDË OPSIONALE PËR TË GJITHË FAKULTETIN E DREJTËSISË**

**VITI I PARË**

| | JURIDIK I PËRGJITHSHËM | C | E DREJTË BIZNESI | C | E DREJTA PUBLIKE & KUSHTETUESE | C | E DREJTA NDËRKOMBËTARE & EUROPIANE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Nocione në filozofi | 5 | Nocione në filozofi | 5 | Nocione në filozofi | 5 | Nocione në filozofi | 5 |
| 2 | Nocione të sociologjisë | 5 | Nocione të sociologjisë | 5 | Nocione të sociologjisë | 5 | Nocione të sociologjisë | 5 |
| 3 | Nocione të shkencave politike | 5 | Nocione të shkencave politike | 5 | Nocione të shkencave politike | 5 | Nocione të shkencave politike | 5 |
| 4 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 | Marrëdhënie ndërkombëtare | 5 |
| 5 | Shkrim akademik II | 3 | Shkrim akademik II | 3 | Shkrim akademik II | 3 | Shkrim akademik II | 3 |
| 6 | Histori e mendimit politik | 5 | Histori e mendimit politik | 5 | Histori e mendimit politik | 5 | Histori e mendimit politik | 5 |
| 7 | Teknika legjislative | 4 | Teknika legjislative | 4 | Teknika legjislative | 4 | Teknika legjislative | 4 |
| 8 | Logjika juridike | 4 | Logjika juridike | 4 | Logjika juridike | 4 | Logjika juridike | 4 |
| 9 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 | Informatikë (njohuri bazë) | 4 |
| 10 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 | Anglisht I / II / III | 3 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Elementë të komunikimit | 5 | Elementë të komunikimit | 5 | Elementë të komunikimit | 5 | Elementë të komunikimit | 5 |
| 2 | Metoda kërkimi | 4 | Metoda kërkimi | 4 | Metoda kërkimi | 4 | Metoda kërkimi | 4 |
| 3 | Etika gjyqësore | 3 | Etika gjyqësore | 3 | Etika gjyqësore | 3 | Etika gjyqësore | 3 |
| 4 | E folura në publik | 4 | E folura në publik | 4 | E folura në publik | 4 | E folura në publik | 4 |
| 5 | Bazat e kontabilitetit | 5 | Bazat e kontabilitetit | 5 | Bazat e kontabilitetit | 5 | Bazat e kontabilitetit | 5 |

**VITI I TRETE**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mjekësia ligjore | 3 | Mjekësia ligjore | 3 | Mjekësia ligjore | 3 | Mjekësia ligjore | 3 |
| 2 | E drejta, etika dhe ligji | 3 | E drejta, etika dhe ligji | 3 | E drejta, etika dhe ligji | 3 | E drejta, etika dhe ligji | 3 |
| 3 | Avokatia | 4 | Avokatia | 4 | Avokatia | 4 | Avokatia | 4 |
| 4 | Noteria | 4 | Noteria | 4 | Noteria | 4 | Noteria | 4 |
| 5 | Penale e krahasuar | 5 | Penale krahasuar | 5 | Penale krahasuar | 5 | Penale e krahasuar | 5 |
| 6 | Statistikë | 4 | Statistikë | 4 | Statistikë | 4 | Statistikë | 4 |
| 7 | Psikiatria gjyqësore | 4 | Psikiatria gjyqësore | 4 | Psikiatria gjyqësore | 4 | Psikiatria gjyqësore | 4 |
| 8 | Kriminalogji – penalogji | 4 | Kriminalogji – penalogji | 4 | Kriminalogji – penalogji | 4 | Kriminalogji – penalogji | 4 |

**IV- LËNDË OPSIONALE SPECIFIKE**

**VITI I PARË**

| C | JURIDIK I PËRGJITHSHËM | C | E DREJTË BIZNESI | C | E DREJTA PUBLIKE & KUSHTETUESE | C | E DREJTA NDËRKOMBËTARE & EUROPIANE | C |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Zgjedhje për të gjitha kurset | | | | Organizatat ndërkombëtare | 3 | Organizatat ndërkombëtare | 3 |
| 2 | | | | | Gjinia dhe ligji | 3 | Qytetërimi Europian | 5 |

**VITI I DYTË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Zgjedhje për të gjitha kurset | | Negocimi i konflikteve & Arbitrazhi | 5 | Negocimi i konflikteve & Arbitrazhi | 5 | Negocimi i konflikteve & Arbitrazhi | 5 |
| 2 | | | E drejta e konkurr./ konsumatorit | 3 | E drejtë publike e krahasuar | 3 | Qeverisja dhe politika në SHBA | 5 |
| 3 | | | E drejta e falimentimit | 3 | Konstitucionalizmi | 3 | Historia e Europës & integrimit evropian | 5 |
| 4 | | | E drejta e pas. e paluajtshme | 5 | Federalizmi dhe Konfederalizmi | 3 | E drejta migracionit dhe refugjatit | 3 |
| 5 | | | E drejta agrare dhe e mjedisit | 3 | Diplomacia dhe protokolli | 4 | Diplomacia dhe protokolli | 4 |

**VITI I TRETË**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Zgjedhje për të gjitha kurset | | Kontratat | 5 | Gjykatat ndërkombëtare | 5 | E drejta e luftës dhe konflikteve | 3 |
| 2 | | | E drejta e autorit dhe internetit | 3 | Shoqëria civile / grupet e interesit | 3 | E drejta e lundrimit | 3 |
| 3 | | | Ekonomi ndërkombëtare | 6 | Te drejtat e njeriut | 3 | Jurisprudenca e Gjykates Eur. DNJ | 4 |
| 4 | | | E drejta e krahasuar private | 5 | E drejta administrative e krahasuar | 3 | E drejta administrative europiane | 3 |
| 5 | | | E drejte bankare & sigurimeve | 3 | E drejta e lundrimit | 3 | Qeverisja, institucionet & politika në BE | 5 |
| 6 | | | E drejta fiskale | 3 | Shteti në prespektive | 3 | E drejta e krahasuar private | 5 |

www.universitetieuropian.com
info@universitetieuropian.com



Themeluesit e Universitetit Europian të Tiranës: Blendi Kajsiu, Adri Nurellari, Ermal Hasimja, Henri Çili

**Universiteti Europian i Tiranës kaloi provën e fillimit. Rreth 180 studentë përfunduan studimet në vitin e parë për nivelin universitar. "Kurrë nuk ke mundësi të dytë të lësh përshtypje të parë"- thonë anglezët. Përshtypjen e parë Universiteti Europian i Tiranës, e ka krijuar tashmë gjatë vitit akademik 2006 – 2007 dhe ajo ndahet mes jush, studentë, pedagogë, bashkëpunëtorë të universitetit apo mes të gjithë atyre aktorëve shoqërorë me të cilët ne patëm këtë vit rastin të bashkëpunojmë, të konsultohemi, të instalojmë një marrëdhënie që ne shpresojmë të vazhdojë gjatë.**

**Nëse një vit më parë, në cilësinë e themeluesve të Universitetit Europian të Tiranës, ne patëm rastin e papërsëritshëm në jetën tonë të nisim një rrugë të re që është njëkohësisht pasioni i jetës sonë, tani e tutje shpresojmë të jemi bashkë me shumë të tjerë.**

**Ndaj, duke Ju mirëpritur në Universitetin Europian të Tiranës, jashtë sloganeve apo marketingut, ne kemi rast të ri të përforcojmë ftesën e fillimit për të gjithë ju studentë, pedagogë, kërkues shkencorë apo aktorë të tjerë të shoqërisë shqiptare. U.E.T. mund të bëhet pjesë e kartivizitës suaj: si student, si studente, si pedagog, si kërkues shkencor apo si bashkëpunëtor.**

ADRI NURELLARI
BLENDI KAJSIU
ERMAL HASIMJA
HENRI ÇILI

Universiteti Europian i Tiranës


regjistrimet >

DIPLOMAT E NIVELIT TË PARË

1- Juridik i përgjithshëm
profile:
a - e drejtë biznesi
b - e drejtë publike
c - e drejtë europiane

2 - Gazetari
3 - Marrëdhënie publike-komunikim
4 - Shkenca politike
5 - Marrëdhënie ndërkombëtare

2007-2008

REGJISTROHUNI TANI!

Tel: 068 20 16 616

TARIFAT
JURIDIK 3000 EURO NË VIT
(7500 EURO PËR TË GJITHË CIKLIN)
DEGËT E TJERA 2500 EURO NË VIT
(6500 EURO PËR TË GJITHË CIKLIN)